



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



DATË/A:	24 NËNTOR 2020
REFERENCË:	872-879/20
PËR/ZA/TO:	AK- “KK Vushtrri”
NGA/OD/FROM:	Blerim Dina - Kryetar i OSHP-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM

Operatori ekonomik **“Rahovica Commerce”shpk – Ferizaj**, si palë e pakënaqur me datën: 30.10.2020, kanë parashtruar në OSHP ankesën me numër 872/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Asfaltimi i rrugëve ne lokale neper fshatra LOT 1 dhe LOT 2”** me nr. të prokurimit: **VU644-20-4423-5-1-1, & Vu644-20-050-5-1-1**, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 1, 6, 7, 59, 61, 69, dhe 108/A të LPP-së.
- Nenin 39 te RRUOPP-së

Operatori ekonomik **“HAXHA KOM”shpk – Skenderaj**, si palë e pakënaqur me datën: 02.11.2020, kanë parashtruar në OSHP ankesën me numër 879/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Asfaltimi i rrugëve ne lokale neper fshatra LOT 1 dhe LOT 2”** me nr. të prokurimit: **VU644-20-4423-5-1-1, & Vu644-20-050-5-1-1**, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 1, 7, 59, 60, 61, 64, dhe 69 të LPP-së.
- Si dhe rregullorja për çmim jo-normalisht te ulet.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 02 Nëntor 2020 kanë autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti profesional i prokurimit me datën 16.11.2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesat e OE ankues **te aprovohen te bazuara dhe lënda te kthehet ne Ri-vlerësim dhe gjate rivlerësimit, AK ti respektoj kriteret e vet-përcaktuara si ne FDT dhe NJK, sipas nenit 59 te LPP-së dhe te respektoj nenin 61 dhe 72 te LPP-së.**

Autoriteti kontraktues- **“KK Vushtrri”** me datën 16 Nëntor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit profesional të prokurimit dhe të njëjtit me datën 23 Nëntor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues **“Rahovica Commerce”shpk – Ferizaj** me datën 16 Nëntor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit profesional dhe të njëjtit me datën 16 Nëntor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues **“HAXHA KOM”shpk – Skenderaj** me datën 16 Nëntor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit profesional dhe të njëjtit me datën 17 Nëntor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues - **“KK Vushtrri”** për aktivitetin e prokurimit **“Asfaltimi i rrugëve ne lokale neper fshatra LOT 1 dhe LOT 2”** me nr. të prokurimit: **VU644-20-4423-5-1-1, & Vu644-20-050-5-1-1** dhe njëkohësisht kanë konstatuar se e OE ankues te **aprovohen te bazuara dhe lënda te kthehet ne Ri-vlerësim dhe gjate rivlerësimit, AK ti respektoj kriteret e vet-përcaktuara si ne FDT dhe NJK, sipas nenit 59 te LPP-së dhe te respektoj nenin 61 dhe 72 te LPP-së, konform mendimit te dhënë ne raportin e ekspertizës.**

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatoreve ekonomik **“Rahovica Commerce”shpk – Ferizaj** si dhe OE : **“HAXHA KOM”shpk – Skenderaj** konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.